

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA TIRANË FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Arb&Trans-2010” shpk
Adresa: Blloku Gintash, 2-katëshet e Biznesit, Shkalla II, Kati i dytë, Laprakë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Për shembjen e njërive të banimit në ndërtesa (pallat) të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Tiranë”- për 6 (gjashtë) pallate”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-31073-05-30-2022

Fondi limit për objektin “Për shembjen e njërive të banimit në ndërtesa (pallat) të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Tiranë”- për 6 (gjashtë) pallate”, është 23,516,753 (njëzet e tre milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 52 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 59; si dhe Udhëzimit Nr.1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

- Operatori ekonomik “ZDRAVO” shpk NUIS K51501008J
- Operatori ekonomik “Arb&Trans-2010” shpk NUIS L02325001T

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Zdravo” shpk

Oferta ekonomike = 19,380,166 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Arb&Trans-2010” shpk

Oferta ekonomike = 23,049,205 (njëzet e tre milion e dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesë) lekë pa TVSH.

Eshte skualifikuar Operator ekonomik i mëposhtëm:

Operatori ekonomik “ZDRAVO” shpk,

Përkatësisht për arsyjet e mëposhtme:

Në zarfën e dorëzuar nga Operatori ekonomik “ZDRAVO” shpk, KVO konstatoi se mungon dokumentacioni: *Formulari i Sigurimit të Ofertës* i kerkuar per Fazën e dyte sipas Fteses per Oferte me Nr.30574 Prot., date 01.09.2022, sipas Shtojcës 5.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Operatorin ekonomik “ARB&TRANS-2010” shpk* se oferta e paraqitur nga ana Juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 19 / 09 / 2022

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.